

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe nenit 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.11-1969/1 datë 30.4.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-1967/2 datë 5.5.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 16-të mbajtur më 5.5.2026, miratoi si vijon:

### **Aktvendim për paralajmërim publik dhe për përjashtimin e ritransmetimit të shërbimeve programore**

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËRON** Operatorin e rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqërinë për tregti dhe shërbime TOTAL TV ShPKNjP Shkup, për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV).

Shkelja e paragrafit (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.11-1969/1 datë 30.4.2026 si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV ShPKNjP Shkup, menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LShMAAV, përkatësisht të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, vepron sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen me ritransmetim të shërbimeve programore.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit përkatësisht vazhdon me kryerjen e shkeljes për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LShMAAV, do të paraqesë kërkesë për inicim të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të saj llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

### **A r s y e t i m**

Agjencia në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LShMAAV ndërmerr masa në pajtim me ligjin në rastet e kryerjes së shkeljes së dispozitave të LShMAAV ose të Rregulloreve të miratuara në bazë të ligjit, kushteve dhe detyrimeve të lejeve.

Në bazë të nenit 28 të LShMAAV, Agjencia është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Kë kuadër të kompetencave ligjore, në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LShMAAV, Agjencia më 27.4.2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore të ritransmetuar nga Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV ShPKNjP Shkup, ku është konstatuar se operatori në fjalë që sipas notifikacionit të Agjencisë së Komunikimeve Elektronike ka të drejtë të kryen veprimtari në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 27.4.2026, për përdoruesit e saj ka

ristransmetuar shërbimet programore që nuk janë të përfshira me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim të nenit 141, paragrafi (13) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar detajisht në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.11-1969/1 datë 30.4.2026, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.11-1969/1 datë 30.4.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-1967/2 datë 5.5.2026, për konstatim të mosrespektim të dispozitave të LShMAAV të cekur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilën për subjektin e lartpërmendur ndërmerret masë paralajmërim publik dhe detyrohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, në mënyrë që të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë vepron sipas urdhëresës, përkatësisht sipas paralajmërimit publik dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.11-1969/1 datë 30.4.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Sasho Stefanovski**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani